



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kuvendi i Kosovës,

Në pajtim me Kreun 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rreg. UNMIK-ut Nr. 2001/9 prej 15 maj 2001),

Në frymën e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 1244/1999 prej 10 qershor 1999,

Konformë propozimit të Qeverisë së Kosovës dhe

Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për shpallje të pazbatueshme për Kosovën të akteve kushtetuese dhe ligjeve, të cilat i ka nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas datës 22 mars 1989,

Në séancën plenare të mbajtur më 11 dhjetor 2003, vendosi:

Të shpallën të pazbatueshme për Kosovën të gjitha aktet kushtetuese, aktet ligjore dhe nënligjore, vendimet si dhe aktet e tjera të cilat i kanë nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas 22. mars 1989, si dhe të anulohen si të kundërligjshme të gjitha efektet e dëmshme që aktet e tilla i kanë shkaktuar në vazhdimësi për Kosovën.

Ngarkohet Qeveria e Kosovës ta përgatisë listën e akteve kushtetuese e ligjore të nxjerra pas 22 marsit të vitit 1989 e cila do të jetë pjesë përbërse e vendimit të Kuvendit të Kosovës.

Prishtinë, 11 dhjetor 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci